

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Fjalimi i Xhumasë i Kalifit të V-të të Xhematit
Islamik Ahmedia,

Hazret Mirza Masroor Ahmedit
mbajtur në Xhaminë Baitul Futuh të Londrës më

25 Gusht 2006

Pranimi i lutjeve

Hazuri e filloi fjalimin e tij duke thënë se jemi fatlum që Allahu na ka mundësuar që të besojmë në Mehdiun dhe Mesihun e Tij, dashnorin dhe shërbëtorin e vërtetë të Muhamedit^{sas}, i cili në bindje të zotërisë së tij (Muhamedit^{sas}) na e mësoi mënyrën e vërtetë të adhurimit. Duke e demonstruar para nesh pranimin e lutjeve, ai e ka forcuar besimin tonë. Duke i sfiduar kundërshtarët e tij ai thoshte se ju po më ofendoni vazhdimisht duke më quajtur mosbesimtar dhe Dexhall, por unë ju jap si argument, krahas shumë argumenteve tjera, pranimin e lutjeve. Demonstroni edhe ju diçka të këtyllë. Por, askush nuk pati guximin të dilte e të matej me të.

Të gjithë ne jemi dëshmitar se çdo ditë e re që po lindë, edhe me gjithë përpjekjet e pareshtura të kundërshtarëve, Xhematit të Mesihut të Premtuar^{ass} po i sjell përparme dhe suksese të reja. Kjo është si rezultat i lutjeve të Mesihut të Premtuar^{ass} dhe të Profetit të Shenjtë^{sas} i cili i ka bërë për Imamin e kohëve të vona dhe për Xhematin e tij.

Sot, para jush do të prezantoj disa raste të pranimit të lutjeve të Mesihut të Premtuar^{ass}, nga të cilat ju do ta shihni qartë trajtimin e Allahut ndaj tij. Se si lutej për shërimin pasuesve të tij, për përparimin e tyre shpirtëror ose për përparimin e Xhematit si tërësi. Kjo e forconte pa masë besimin e atyre që ishin dëshmitarë të këtyre mrekullive; por edhe besimin tonë kur lexojmë për ato ndodhi. Ka shumë ndodhi të kësaj natyre, por siç thash më parë, unë këtu do t'i përmendi vetëm disa prej tyre.

Së pari do ta përmend një ndodhi, e cila në shikim të parë duket të jetë një diçka e pa rëndësishme, por e cila në fakt flet për karakterin e Mesihut të Premtuar^{ass} i cili kujdesej deri në imtësi për plotësimin e nevojave e të krijesave të Allahut. Hazret Mirza Bashir Ahmedi rrëfen se një herë Mesihu i Premtuar^{ass} po kthehej nga një shëtitje dhe tek po futej në shtëpi, një lypës nga distanca lypoi diçka. Mesihu i Premtuar^{ass} ishte i rrethuar nga shumë njerëz dhe zëri i lypësit u mund nga prezenca e njerëzve dhe Mesihu i Premtuar^{ass} hyri në shtëpi. Pas një kohe zëri i lypësit i jehoi në vesh dhe ai menjëherë doli nga shtëpia dhe pyeti se ku kishte mbetur lypësi që ishte më parë këtu? Dikush i tha se kishte shkuar. Ai u kthye brenda por nuk po bëhej rehat. Pas ca kohe përsëri e dëgjoji thirrjen e të njëjtit lypës. Doli menjëherë e i dha ca para dhe pasi u largua Mesihu i Premtuar^{ass} tha se pak më parë ishte lutur që ai të kthehej përsëri që të mund t'i jepte diçka.

Përmes Mesihut të Premtuar^{ass} njerëzit shëroheshin nga sëmundjet shpirtërore dhe hajnat e grabitësit bëheshin njerëz të shenjtë përmes fuqive të tija shpirtërore. Gjithashtu përmes fuqive të tija shpirtërore, shëroheshin edhe shumë të tjerë që vuanin nga sëmundje fizike.

Një grua plakë me emrin Amtullah e kujton një ndodhi që i kishe ndodhur në moshën dhjetë vjeçare. Ajo ishte bija e Sajed Ahmed Nurit i cili për hir të Mesihut të Premtuar^{ass}, me familjen dhe vëllezërit e tij kishte emigruar në Kadijan. Ajo thotë se në fëmijëri kam vuajtur shumë nga një sëmundje e syve e cila më shkaktonte shumë dhembje. Prindërit e saj kishin bërë çmos për ta shëruar, por sëmundja sa vinte e rritej. Një herë kur nëna e saj po mundohej t'i hidhte ca pika në sy, ajo refuzoi t'i merrte dhe i iku nga duart dhe shkoi te Mesihu i Premtuar^{ass} dhe duke qarë i tha se nga dhembja nuk po mund të zë vend askund dhe s'po mund t'i hapë sytë. Sytë më ishin ënjtur dhe skuqur. Mesihu i Premtuar e lagu gishtin me pështymën e tij dhe m'i preku sytë. E vuri dorën e tij mbi kokën time dhe tha: "Qupëza ime, tani mund të shkosh dhe kurrë më nuk do të vuash nga kjo sëmundje". Ajo thoshte se tani jam shtatëdhjetë vjeçare dhe prej asaj kohe sytë e mi kurrë më nuk më kanë munduar dhe për shkak të lutjes së Mesihut të Premtuar^{ass}, kurrë më nuk kam pasur ndonjë problem me ta.

Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se një herë biri im Bashir Ahmedi ishte i sëmurë nga një sëmundje e syve dhe me gjithë trajtimin për një kohë të gjatë nuk dukeshin shenja përmirësimi. Iu luta Allahut dhe Ai përmes një revelate më lajmëroi për shërimin e tij dhe të njëjtën ditë sytë e tij u shëruan.

Në librin e tij "Hakikatul vahi" Mesihu i Premtuar^{ass} e përshkruan një tjetër ndodhi. Një herë djali i Sardar Navab Muhamed Ali Khan Sahibit kishte temperaturë të lartë dhe të gjithë e humbën shpresën se do të mbijetonte. Në këtë situatë unë u luta për të, por mu bë me dije se vdekja e tij nga kjo sëmundje ishte e pa shmangshme. Pastaj e luta Allahun që ta pranonte ndërmjetësimin tim. Allahu më tha "Mandha ladhi jashfahu il'la bi idhnih" – "Kush mund të ndërmjetësoj tek Unë pa lejen Time" dhe unë heshta. Pas pak Allahu tha "Ila antakal maxhaz" - "Leja të është dhënë". Pastaj, unë u luta thellësisht dhe lutja ime u pranua dhe djali i tij sikur doli nga varri dhe u shërua dhe sot e kësaj ditë është shëndosh e mirë.

Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se më pesë gusht 1906, gjysma e trupit tim ishte pa ndjenja dhe nuk mund të hidhja asnjë hap. Këmbët nuk po më mbanin. Sëmundja ishte gjithashtu e shoqëruar me shumë dhimbje. Mendova për kënaqësinë e armiqve dhe pastaj iu luta Allahut duke i thënë se e di që vdekja është e pashmangshme, por Ti e di se një vdekje e parakohshme do të jetë burim kënaqësie për armiqtë. Pastaj Allahu më shpalli në arabisht "Allahu ka mundësi për gjithçka dhe Allahu nuk e ç'nderon shërbëtorin e Tij". Beto hem në emrin e bekuar të Atij në dorën e të cilit është jeta ime dhe që më shikon tani dhe e di se a e them të vërtetën apo gënjej, se brenda një gjysmë ore më mori gjumi dhe fjeta dhe kur i hapa sytë, pashë se nuk kishte më shenja sëmundjeje në trupin tim. Gjersa të gjithë po flinin unë u zgjova dhe po ecja dhe e kuptova se isha shëruar. Pastaj derdha lot i emocionuar nga kjo mrekulli dhe nga fakti se sa i fuqishëm është Zoti ynë dhe se sa fatlumë jemi ne që kemi besuar në Të, në Librin e Tij dhe

e kemi pasuar të Dërguarin e Tij; dhe se sa të mjerë janë ata që nuk kanë besuar në këtë Zot të mrekullueshëm.

Siç e dimë murtaja u dërgua nga Allahu si shenjë në favor të Mesihut të Tij, nga e cila në Indi qindra mijëra njerëz vdiqën. Allahu e kishte lajmëruar Mesihun e Premtuar^{ass} se ata që do të besojnë në ty dhe ata që janë brenda mureve të shtëpisë sate do të jenë të mbrojtur nga kjo epidemi. Kjo ishte një shenjë e madhe, por pas disa ditësh, Hazret Mirza Bashir Ahmedi, djali i tretë i Mesihut të Premtuar^{ass}, u sëmur nga temperatura e lartë. Mesihu i Premtuar^{ass} u shqetësua jashtë mase dhe duke e përmendur këtë rast thotë: “Gjatë kohës së mortajës, në Kadijan djali im Bashir Ahmedi u sëmur. Kishte temperaturë të lartë nga e cila e humbi edhe vetëdijen. Thashë me vete se edhe pse vdekja është e pashmangshme, por nëse biri im do të vdiste në këtë kohë të mortajës, atëherë armiq të do të mund të thoshin se ka vdekur nga mortaja dhe do ta mohojnë revelatën në të cilën Allahu më ka premtuar “Inni uhafidhuka kula man fiddaar” – "Kush është brenda mureve të shtëpisë sate është i mbrojtur". Isha aq shumë i frikësuar sa që s'mund ta shpreh me fjalë. Ishte përafërsisht mesi i natës dhe gjendja e fëmijës ishte shumë serioze dhe mua më kaploi një frikë, që nuk ishte frikë e zakonshme që mund të shprehet me fjalë. Vazhdimisht po mendoja se nëse djali im do të vdiste atëherë armiq të do të kishin shumë material kundër meje. Atëherë u futa në namaz dhe pas pak pata një ndjenjë të fortë se lutja më është pranuar. Betohe në Zotin në dorën e të cilit është jeta ime se i kisha kompletuar vetëm tri rekate kur u gjenda në një gjendje vizioni dhe e pashë atë të shëruar. Kur e përfundova faljen pashë se fëmija ishte ngritur ulur në shtrat dhe po kërkonte ujë. E preka dhe e pashë se nuk kishte temperaturë dhe vetëdija i ishte kthyer. Ky rast ma forcoi edhe më shumë besimin në fuqitë e Zotit.

Në librin e tij "Kitab zul khilafah" në faqen 62 Mesihu i Premtuar^{ass} shkruan: U luta që armiq të vuanin nga mortaja. Kjo ishte për ata armiq që nuk do të udhëzoheshin. Pastaj sipas profecisë mortaja ra dhe qindra mijëra njerëz vdiqën. Revelata në persisht nga Allahu thoshte ‘O murtajë që i ke shkretuar shtëpitë e armiqve!’ dhe kjo ishte publikuar në revistat ‘Al Hakam’ dhe ‘Al Badër’. Shumë njerëz e pranuan të vërtetën. Pastaj dënimi i mortajës ra mbi ta si shi i rrëmbyeshëm dhe rreth tre milion njerëz vdiqën prej saj.

Një hoxhë nga Amritsari që ishte armik i xhematit, shkroi një libër në të cilin s’la gjë pa thënë kundër meje. Ai e donte jetën e kësaj bote dhe fliste gënjeshtër dhe vdiq nga mortaja. Pastaj Muhamed Bakshi, inspektor i Batalës i cili gjithmonë kishte qenë kundër meje, vdiq gjithashtu nga mortaja. Qiragh Dini i Xhamisë u ngrit dhe e pohoi vetën profet duke më quajtur Dexhall dhe tha se mua më është dhënë ai shkop me të cilin do ta vras këtë Mesih të rremë. Ai gjithashtu vdiq sipas profecisë të cilën e kam botuar gjatë jetës së tij. Ai vdiq më 4 prill 1906 bashkë me dy djemtë e tij. Çka ndodhi me ‘shkopin’ e tij me të cilin lavdërohej se do të më

vriste? Ka edhe shumë të tjerë që kishin shkuar larg në kundërshtim dhe ditë e natë ishin të zënë me përqeshje e fyerje dhe më në fund vdiqën nga mortaja.

Rreth asaj kohe dikush më shkroi nga Lahori duke më treguar se axha i tij me emrin Nur Ahmed që jetonte në Tafsil Afsabad thoshte se Mirza Sahibi nuk është duke paraqitur asnjë argument në favor të vërtetësisë së tij. Unë i thash se njëra nga shenjat e tij është mortaja e cila është duke i gëlltitur njerëzit. Ai tha se mortaja nuk do të na prekë neve, në fakt ajo ka ardhur për t'ia ngrënë kokën vetëm Mirza Sahibit. Kur mbërrita në Lahor, thotë ai, më erdhi lajmi se axha im kishte vdekur nga murtaja.

Pastaj është një Zeinul Abedin i cili i kishte përfunduar studimet fetare dhe punonte si mësues, ai kishte debatuar në një dyqan me një ahmedian dhe pas kësaj vdiq nga murtaja; dhe jo vetëm ai por edhe gruaja e tij me të atin dhe 14 anëtarë të tjerë të familjes. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se është shumë e çuditshme që unë qenkam gënjeshtari, por ata gëlltiten nga mortaja kur debatojnë me mua. A do të thotë kjo se Zoti është në anën e gënjeshtarëve. Dhe jo vetëm që vdesin por vdesin të poshtëruar. Pastaj një Kerim Baksh nga Lahori më shante dhe më akuzonte vazhdimisht. Unë u mundova ta ndaloja por ai nuk dëgjonte dhe në moshë të re vdiq nga mortaja.

Sahabët e Mesihut të Premtuar^{ass} kishin aq besim të paluhatshëm në lutjet e tij sa që vetëm kur u thoshte në ndonjë letër se ishte lutur për ta, kjo i mbushte zemrat e tyre me besim dhe ata ishin të sigurt se lutjet e tij do të pranoheshin. Hazret Mirza Bashir Ahmed shkruan se një herë Molvi Rrahim Baksh më tregoi se gjyshi i tij, të cilin njerëzit e quanin Kalif, ishte kundërshtar i Mesihut të Premtuar^{ass} dhe vazhdimisht fliste keq për të dhe e shante. Ai gjithashtu e shqetësonte babin tim që ishte ahmedian. Babai im i shkroi Mesihut të Premtuar^{ass} i cili iu përgjigj se në letër se ishte lutur dhe se ai nuk do të flas më keq. Babai im u tregoi të gjithëve që Mesihu i Premtuar^{ass} ishte lutur dhe se Khalifa nuk do flasë më keq. Ditën tjetër ishte e xhuma dhe gjyshi im bashkë me joahmedianët e tjerë shkoi për ta falur xhumanë, por pas xhumasë ai ishte i heshtur, më gjithë shprehitë i tij që në raste të tilla ta shante e akuzonte Mesihun e Premtuar^{ass}. I thanë pse s'po dëgjohesh sot? Ai tha se ç'mund të fitojë njeriu duke i akuzuar të tjerët. Sa do i keq qoftë dikush, njeriu nuk duhet ta shajë. Nëse qenka kështu, pse atëherë për çdo ditë ti e akuzoje atë, ç'ka ndodhur sot? Molvi Rahim Baksh Sahib thoshte pastaj se me gjithë nxitjen e njerëzve, gjyshi im kurrë më nuk e akuzoi Mesihun e Premtuar^{ass} dhe nuk e shqetësoi më babanë tim që ishte ahmedian.

Tani do t'i përmend dy raste të pranimit të lutjeve të Mesihut të Premtuar^{ass}. Sheh Muhamed Baksh Sahib rrëfen se një herë Mesihu i Premtuar^{ass} po rrinte në shtëpinë e Mia Qirag Dinit. Ishte rreth orës 22:00 (të mbrëmjes). Kishte kohë që s'kishte rënë shi dhe dikush kërkoi nga Mesihu i Premtuar^{ass} që të lutej për shi.

Mesihu i Premtuar^{ass} nuk tha asgjë dhe vazhdoi të fliste. Edhe dikush tjetër kërkoi nga ai që të lutej dhe ai përsëri nuk ia vuri veshin. Pas pak edhe një tjetër e përsëriti të njëjtën lutje. Atëherë Mesihu i Premtuar^{ass} i ngriti duart dhe filloi të lutej. Hëna po shndriste dhe qielli ishte i kthjellët, por sapo Mesihu i Premtuar^{ass} filloi të lutej një re u duk dhe filloi të binte shi. Kur ai e përfundoi lutjen dhe i uli duart, reja përsëri u zhduk dhe shiu u ndal.

Munshi Ahmed Zafar Ahmed Sahib rrëfen se një herë unë dhe Munshi Rora Sahib e vizituam Kadijanin në një kohë shumë të nxehtë. Kur po ktheheshin nga Kadijani e vizituam Mesihun e Premtuar^{ass} për t'u përshëndetur dhe Munshi Rora Sahib i tha Mesihut të Premtuar^{ass} se po bënte kohë shumë e nxehtë dhe e luti që të lutej për shi dhe tha le të bie shumë, që të kemi ujë mbi ne e nën ne. Unë qesha dhe thashë: Hazur kështu lutu vetëm për të dhe jo për mua. Edhe Mesihu i Premtuar^{ass} buzëqeshi dhe i ngriti duart e u lut para se të përshëndeteshim. Kur u nisëm nuk kishte asnjë re dhe qielli i kthjellët. Kishim bërë vetëm pakë rrugë nga Kadijani për në Batala dhe papritmas qielli filloi të errësohej dhe filloi të binte një shi i madh sa që të gjitha kanalet u mbushën me ujë. Papritmas karroca ra në një gropë dhe Munshi Sahib u rrëzua nga karroca dhe ra në një pus me ujë dhe u bë qull i tëri. Unë zbrita dhe duke i ndihmuar që të ngrihej i thash me shaka: Tani përsëri kërkoi nga Mesihu i Premtuar^{ass} që të lutet për ujë mbi ty dhe nën ty.

Edhe kundërshtarët gjithashtu besonin në pranimin e lutjeve të Mesihut të Premtuar^{ass}. Mesihu i Premtuar rrëfen se si një herë një hindu me emrin Bashambar Das ishte dënuar me një vit e gjysmë burgim dhe vëllai i tij Sharampati kërkoi nga unë që të lutesha për të. U luta për të dhe pashë në ëndërr se shkova në zyrën ku ishin të regjistruar emrat e të burgosurve. E hapa regjistrin e emrave, e gjeta emrin e tij dhe e ndërrova kohëzgjatjen e dënimit duke e shkurtuar për gjysmë. Nga ëndrra gjithashtu kuptova se lënda e tij do të kthehej në gjykatën e qarkut dhe se dënimi do t'i përgjysmohej, por se nuk do të lirohej menjëherë. Ia thash vëllait të tij Lala Sharampatit të gjitha këto para se gjyqi të merrte vendim dhe më në fund përfundimi ishte siç e pata parë në ëndërr.

Nga 1880 deri më 1884 Mesihu i Premtuar^{ass} i botoi katër vëllimet e librit të tij 'Brahine Ahmedia'. Kjo ishte në një kohë kur krishterizmi ishte në kulmin e fuqisë së tij dhe të krishterët po e sulmonin Islamin nga të katër anët. Madje edhe muslimanët ishin në dyshim rreth Islamit dhe po e braktisnin atë. Askush deri atëherë nuk ishte ngritur në mbrojtje të Islamit. Mesihu i Premtuar^{ass} u ngrit dhe me argumente të pathyeshme e vërtetoi se Kurani i Shenjtë është fjala e Allahut dhe Profeti i Shenjtë^{sas} është vulë e profetëve dhe i sfidoi të gjithë, që nëse dikush mund të jepte sa një të pestën e argumenteve të tija, ai do t'i jepte atij dhjetë mijë rupi si shpërblim. Por askush nuk e pranoi sfidën e tij. Dijetarët e atëhershëm muslimanë, ndër ta edhe Muhamed Husein Batalvi, njëri nga liderët e sektit Ahle Hadith, i cili më vonë do të bëhej kundërshtar i madh i Mesihut të Premtuar^{ass},

s'lanë lëvdatë pa thënë për këtë libër. Ky libër i ndali sulmet e të krishterëve dhe i bëri ata t'ia mbathnin me të katërtat; dhe ende janë duke ikur.

Kur e shkroi librin në fjalë, gjendja e tij financiare ishte shumë e keqe dhe po e vriste mendjen se si do të mund ta botonte këtë libër në mbrojtje të Islamit. Më në fund Allahu i pranoi lutjet e tij dhe i largoi brengat e tij. Mesihu i Premtuar^{ass} e deklaroi publikimin e tij si një shenjë të Allahut. Ai vetë flet për të, në një rast dhe thotë, se kur e shkrova librin 'Brahine Ahmedia', që ishte libri im i parë, nuk kisha para për ta publikuar. Në atë kohë isha njeri i panjohur dhe nuk e njihja askënd. Atëherë iu luta Allahut nga i cili më zbriti revelata në këto fjalë: "Shkunde palmën dhe hurma të freskëta do të bien". Sipas kësaj revelate, së pari ia shkrova një letër Khalifa Muhamed Hasan Sahibit dhe ashtu siç kishte premtuar Allahu ai i dërgoi 250 rupi, për t'i pasuar edhe me 250 të tjera më pas, të cilat në atë kohë ishin një shumë e madhe. Edhe disa të tjerë më ndihmuan me para dhe në këtë mënyrë, me gjithë shpresat të pakta libri u botua. Ka shumë dëshmitar të kësaj ngjarjeje, dhe jo vetëm myslimanë, por edhe hindusë.

Të ju them diçka më shumë rreth këtij libri, thotë Kalifi. Megjithëse shumë njerëz e ndihmuan Mesihun e Premtuar^{ass} në botimin e librit, disa hoxhallarë duke u frikësuar nga Qeveria Britanike refuzuan ta ndihmonin. Navab Sadik Hasan Khani së pari i porositi ca kopje dhe pastaj tha se nuk do t'i pranonte. Ai ishte një dijetar i njohur i sektit Ahle Hadith dhe ishte i martuar nga familja Navab dhe kishte arritur famë të lartë. Ai ishte gjithashtu edhe autor i disa librave fetare. Prandaj, Mesihu i Premtuar^{ass} mendoi se ai duhet të ndjej diçka në zemrën e tij për Islamin dhe e përkujtoi që të ndihmonte në botimin e këtij libri në mbrojtje të Islamit. Kur i arriti libri ai shqeu dhe e ktheu mbrapa ashtu të shqyer. Kur libri i shqyer i erdhi mbrapa Mesihun e Premtuar^{ass}, ai u ndje shumë i ofenduar. Transmetuesi thotë se gjatë gjithë jetës sime kurrë nuk e kam parë Mesihun e Premtuar^{ass} të jetë ndjerë kaç keq. Fytyra e tij shprehte një pakënaqësi të madhe. Vazhdonte të ecte dhe nuk bënte vër me gojë. Papritmas tha: "Mirë, pra, bëja qejfin qeverisë sate" dhe pastaj tha: "Qoftë turpëruar dhe pa nder". Në vëllimin e katërt të librit, Mesihu i Premtuar^{ass} shkroi se ne nuk mbështetemi në Navab Sadikun, por mbështetemi në Zotin tonë dhe Ai është i mjaftueshëm për ne. Dhëntë Zoti që Qeveria Britanike të jetë e kënaqur me të.

Vetëm pas disa muajsh, Qeveria Britanike, për kënaqësinë e së cilës Navab Sadiku e kishte refuzuar librin, kishte iniciuar një padi politike kundër tij. Navab Sadiku ishte shumë i shqetësuar dhe kishte rënë në hall të madh. Të gjitha i provoi që të dilte nga kjo situatë, por asgjë nuk funksionoi. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se kjo që i ka ndodhur Navab Sadikurt është si rezultat i profecisë sime që është shkruar në Burahine Ahmedia. Ai e ka shqyer librin tim dhe unë jam lutur që Allahu ta shqyej nderin e tij, dhe pikërisht kjo ndodhi'. Kur e kuptoi se kishte bërë gabim, me përlulje të skajshme e luti Mesihun e Premtuar^{ass} që të lutej për të. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se duke e parë gjendjen e tij të mjerueshme, më erdhi keq dhe u

luta për të dhe si rezultat Allahu më njoftoi se ai do të kursehej. Më vonë ai pranoi një letër nga Qeveria në të cilën shkruhej se titulli Navab to t'i rikthehej. Pastaj, rreth një mrekullie nga lëmi i diturisë. Sheik Jakub Ali Sahibi rrëfen se në fillim Mesihu i Premtuar^{ass} nuk kishte botuar asgjë në arabisht dhe të gjitha botimet e tija ishin në urdu ose pjesërisht në persisht. Një herë Abdul Kerim Sahibi i sugjeroi Mesihut të Premtuar^{ass} që të shkruante diçka në arabisht. Mesihu i Premtuar^{ass} tha se nuk di arabisht. Molvi Abdul Kerimi ishte një njeri shumë joformal dhe në mënyrë jo formale i tha se unë nuk po them se ju dini arabisht, ajo që dëshiroj është që ju të ngjiteni në malin Sinaj dhe të sillni diçka prej atje. Mesihu i Premtuar^{ass} tha se do të lutej për këtë. Mesihu i Premtuar^{ass} u fut brenda dhe pas një kohe doli duke buzëqeshur dhe tha se pasi ishte lutur kishte filluar të shkruante në arabisht dhe iu duk fare e lehtë. Ja, këtu kam sjellë njëqind rreshta të një poeme në arabisht që sapo e shkrova. Këta do të ishin rreshtat e parë të botuara në arabisht në librin e tij 'Aina kamalati Islam'. Pas kësaj ai shkroi shumë libra në arabisht, bile i sfidoi dijetarët e kohës që të dilnin e të mateshin me të në arabisht, por askush nuk e pranoi sfidën e tij.

Kalifi thotë se të gjitha aktivitetet e Mesihut të Premtuar^{ass} vareshin nga lutjet. Pjesën më të madhe të kohës ai e kalonte në lutje. Ai lutej para çdo përpjekje dhe vazhdimisht i përkujtonte të tjerët që të luteshin. Ai besonte në lutje aq thellë sa që thoshte se asgjë nuk është aq efektive si lutjet dhe kjo është arma kryesore e suksesit. Ai thoshte se s'ka argument më të madh rreth ekzistencës së Zotit se lutjet dhe pranimi i tyre. Lutjet e pranuar të dikujt janë dëshmi se ai njeri ka një nder dhe respekt në oborrin e Allahut. Edhe pse lutjet nuk mund të pranohen në çdo kohë, sepse nganjëherë Allahu dëshiron që shërbëtorët e Tij ta pranojnë vullnetin e Tij, por nuk ka dyshim se lutjet e atyre që janë pranuar në oborrin e Allahut, krahasuar me të tjerët, pranohen shumë më shumë dhe askush nuk mund të matet me ta në pranimin e lutjeve. Unë betohem se mijëra lutje të miat janë pranuar. Po t'i shkruaja do të bëhej një libër voluminoz.

Hazret Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se ka një lidhje mes lutjes dhe pranimi të saj e cila ekziston që prej kur ekziston njeriu. Sa herë që Allahu dëshiron të bëj diçka, ai e inspiron dikë nga robët e Tij të sinqertë që të lutet thellësisht dhe të përpiqet që kjo gjë të bëhet. Pastaj, lutjet e këtij njeriu të Zoti pranohen dhe Allahu krijon kushte që ajo gjë të ndodh. Përmes lutjes ju mund ta njihni Allahun dhe të mësoni rreth ekzistencës së Tij i cili përndryshe është i fshehur pas shumë mbulesash. Mesihu i Premtuar^{ass} thotë se po të mos kishte ekzistuar lutja askush nuk do të kishte pasur besim të plotë në ekzistencën e Zotit. Si rezultat i lutjeve ne pranojmë revelata, komunikojmë me Allahun dhe kur njeriu lutet me sinqeritet dhe me ndjenja të thella atëherë Zoti i gjallë e manifeston Vetën e Tij, që për të tjerët mbetet e fshehur. Qëllimi i lutjeve nuk është vetëm arritja e qëllimeve tona, të cilat mund të jenë materiale, por në fakt askush pa ndihmën e atyre shenjave që paraqiten pas pranimi të lutjeve nuk mund ta gjej Zotin e Vërtetë. Injorantët

mendojnë se lutjet janë të kota dhe joefektive. Ata nuk e dinë se janë vetëm lutjet përmes së cilave Allahu e manifeston Vetën e Tij në zemrat e njerëzve. Secili që është i etur për ta njohur Allahun duhet ta dijë se mjeti i vetëm për ta njohur Atë është lutja, përmes së cilës Allahu i largon të gjitha dyshimet. Sepse atë që njeriu e arrin pa lutje, ai nuk e di se si e ka arritur atë gjë.

Allahu na e forcoftë vazhdimisht besimin në lutje dhe na mundësoftë që në oborrin e Tij të llogaritim ndër të dashurit dhe të zgjedhurit e Tij. Amin!

This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of 25 August 2006. The topic of this Khutba is "The exceptions of prayers of the Promised Messiah^{ass}". This translation has been done by the members of Kosovo Jama'at